



LISTA KONTROLLUESE E PUNËDHËNËSIT PËR VETËVLERËSIM

PJESA 3:	MASAT SPECIFIKE PARANDALUESE
Tema 3.1.	PJISJET PERSONALE MBROJTËSE NË VENDIN E PUNËS
Ligji / rregulloret përkatëse:	• Rregullore (MPMS) Nr.02/2016 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve personale mbrojtëse në vendin e punës.
Shkurtesa:	• PPM – Pajisje Personale Mbrojtëse • MPMS – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Përdorimi i listës kontrolluese:	Nëse përgjigjeni “Po” në një pyetje, ju lutemi kaloni në pyetjen tjetër, në rast se përgjigjeni “Jo” bëni vërejtje që mund të ndërmerren veprime për t’i përmbushur kërkesat ligjore.

Nr.	Pika kontrolli	Po	Jo	Vërejtje për zbatimin
	PARA VIZITËS NË LOKACION / VENDET E PUNËS			
	<i>* Bëhuni gati për vizitën në lokacion - nëse nuk i mbani mend kërkesat tuaja të brendshme për përdorimin e PPM-ve (p.sh. katalogët e pajisjeve personale mbrojtëse, rregullat), lexojini përsëri dokumentet për të qenë gati për vizitën në lokacion!</i> <i>* Gjatë vizitës në vendet e punës, do t’ju duhet të mbani shënime. Është më e lehtë të mbani shënime të strukturuar, për shembull duke përdorur formularët e inspektimit. Merrini me vete. Përmbajtja e formularëve të inspektimit varet nga vendi i punës që do të vizitoni. Nëse nuk keni formularë inspektimi, përgatisni formularë të mirë dhe lehtësisht të kuptueshëm (p.sh. duhet të përfshihet vendi i inspektimit, data/ora, ekipi i inspektimit dhe të punësuarit e inspektuar, lista e PPM-ve që kërkohen për të kryer detyrën/punën, etj.).</i>			
	MBIKËQYRJA E LOKACIONIT / VENDEVE TË PUNËS			
	<i>* Jepni shembullin tuaj, përdorni PPM-të në varësi të rreziqeve që ekzistojnë në lokacion / vendet e punës!</i>			

	* Gjatë vizitës në lokacion / vendet e punës duhet të tregoni vëmendje nëse të punësuarit përdorin PPM, mbani shënime (duke mbushur formularët e inspektimit) për vendet e vëzhguara të punës dhe bëni fotografi aty ku shihet përdorimi/mungesa e PPM-ve. * Kushtojini vëmendje shembujve të mirë dhe jo të mirë. * Bisedoni me të punësuarit, tregohuni miqësor, shpjegoni dhe këshillojini si PPM-të mund ta mbrojnë shëndetin e tyre!			
1.	A i përdorin PPM-të të gjithë personat në lokacion / vendin e punës? * Nëse nuk i njihni personat, bisedoni me personat që nuk i përdorin PPM-të, kush janë ata (të punësuar, vizitorë, nënkontraktorë). Përgjigjet do t'ju lejojnë të specifikoni masat parandaluese që duhen marrë (p.sh. përmirësimi i punës me nënkontraktorët, pajisja e vizitorëve me PPM). * Pyetni të gjithë të punësuarit që nuk i përdorin PPM-të, cilat janë arsyet e mos përdorimit të PPM-ve? Pse (përgjigjet në këtë pyetje mund të çojnë në përgjigje në pyetje të tjera, p.sh. nuk ka numër të mjaftueshëm të PPM-ve që ju keni siguruar ose nuk janë nuk të rehatshme. Ju nuk keni nevojë t'i përsëritni këto pyetje).			
2.	A i përdorin të punësuarit PPM-të sipas udhëzimeve tuaja? Rregullore (MPMS) Nr.02/2016, Neni 8.5 * Shënoni rreziqet që keni identifikuar se ekzistojnë në vendin e punës dhe se nuk përdoren PPM-të, mbani evidencë të rreziqeve dhe mungesës së PPM-ve (p.sh. fotografi). Më vonë do t'i kontrolloni dokumentet tuaja për të kontrolluar nëse është specifikuar se cilat PPM duhet të përdoren.			
3.	A sigurohen PPM-të falas nga ju?			

	Rregullore (MPMS) Nr.02/2016, Neni 5.3			
4.	A sigurojnë PPM-të mbrojtje efektive ndaj rreziqeve/kushteve ekzistuese dhe nuk rrisin rreziqet e tjera? Rregullore (MPMS) Nr.02/2016, Neni 6.3.1, 6.3.2, 7.1.3. <i>* Kontrolloni të gjitha llojet e PPM-ve (p.sh. respirator + mbrojtës të ajrit + helmetë ose doreza / respirator / rripa sigurie, etj., p.sh. nëse i punësuarit është i ekspozuar në pluhur, kontrolloni nëse respiratori ka filtër pluhuri, nëse personi është duke punuar me kimikate, kontrolloni nëse materiali i dorezave është mbrojtës ndaj kimikateve të veçantë, etj. Në rast se identifikoni probleme, zëvendësojini PPM-të e dëmtuara me ato të reja ose riparojini, nëse është e mundur, sipas specifikimeve teknike dhe konsultimit me prodhuesin e PPM-ve).</i>			
5.	A janë të mirëmbajtura PPM-të (p.sh. nuk janë thyer, riparohen me metoda të papërshtatshme, të ndotura në nivel ekstrem)? Rregullore (MPMS) Nr.02/2016, Neni 5.4 <i>* Pyetni të gjithë të punësuarit të cilët përdorin PPM të mirëmbajtura jo mirë - pse?</i>			
6.	A janë PPM-të të rehatshme për të punësuarit, a përputhen me PPM-të e tjera, a janë të rregulluara në mënyrë adekuate për madhësinë (p.sh. helmetat, kapëset e sigurisë) apo përshtaten me madhësinë? Rregullore (MPMS) Nr.02/2016, Neni 6.3.3, 6.3.4, 6.4 <i>* Vëzhgoni nëse PPM-të përdoren siç duhet.</i> <i>* Pyetni të gjithë të punësuarit që përdorin PPM nëse janë të rehatshme.</i> <i>* Pyetni të gjithë të punësuarit që nuk përdorin PPM - pse?</i>			

	<i>* Nëse madhësia nuk është e rregulluar - ndihmoni në rregullimin.</i>			
7.	A plotësohen kërkesat higjienike nëse disa persona përdorin PPM të njëjta? Rregullore (MPMS) Nr.02/2016, Neni 6.7 <i>* Pyetni të paktën 2-3 të punësuar që përdorin PPM (p.sh. respiratorë, doreza dhe çizme) në qoftë se ata janë përdoruesit e vetëm të PPM-ve të veçanta. Nëse të njëjtat PPM përdoren nga disa persona - pyesni si pastrohen PPM-të nga pikëpamja higjienike e përdorimit (p.sh. çizmet e sigurisë nga brenda kundër kërpudhave të thonjve). Nëse të punësuarit thonë se janë përdorues të vetëm, kalojeni këtë pyetje. Në rast se identifikoni probleme, parashtrojani këtë pyetje më shumë të punësuarve.</i>			
8.	A Janë të punësuarit të informuar/trajnuar pse duhet t'i përdorin PPM-të? Rregullore (MPMS) Nr.02/2016, Neni 8 <i>* Pyesni të gjithë të punësuar për çka, kur dhe pse duhet t'i përdorin PPM-të (p.sh. kur dhe pse duhet të përdorni dorëza, ose kur do të punoni me ndonjë kimikat, çfarë dorëzash do të përdorni, ku janë këto dorëza). Nëse ata nuk janë të vetëdijshëm, përfshijeni këtë temë në trajnimin e ardhshëm për SSHP.</i>			
9.	A janë PPM-të të shënuara me shenjë CE? Rregullore (MPMS) Nr.02/2016, Neni 6.1, 6.2 <i>* Kontrolloni të gjitha llojet e ndryshme të PPM-ve (p.sh. respirator + mbrojtës veshësh + helmetë ose dorëza / respirator / rripi i sigurisë). Në rast se identifikoni probleme, mbani shënime dhe zëvendësojini sipas standardeve me shënimin CE. Kur planifikoni të blini të reja, duhet të bëni specifikimin teknik bazuar në standarde me shënimin</i>			

	<i>CE, gjithashtu mos e pranoni dorëzimin nëse nuk përmbushen këto kërkesa.</i>			
	KONTROLLIMI I DOKUMENTEVE NË ZYRË			Komenti i projektit: Nuk është e qartë se çka nënkuptohet me udhëzimet e përmendura në 8.2 (udhëzimet e lidhura), 8.5. (PPM-të të përdoren në përputhje me udhëzimet e punëdhënësit dhe prodhuesit). A janë këto udhëzime me shkrim? A duhet të bëjmë një pyetje nëse keni udhëzime të shkruara? A duhet të regjistroni pranimin e udhëzimeve (8.2.) / trajnimit (8.3.)? A janë këto të ndryshme?
	* Nëse keni një ofrues të jashtëm të shërbimit të SSHP-së ose ekspertin për SSHP, takohuni me të/ata. * Ftoni përfaqësuesin e të punësuarve të merrë pjesë në kontrollimin e dokumenteve.			
10.	A keni vlerësuar nëse risqet mund të shmangen ose të reduktohen në mënyrë të mjaftueshme nga mjetet teknike të mbrojtjes kolektive ose nga masat, metodat ose procedurat e organizimit të punës? Rregullore (MPMS) Nr.02/2016, Neni 4, 7.1.2 * Kontrolloni dokumentin e vlerësimit të riskut për të identifikuar nëse është vlerësuar mundësia e zbatimit të masave të tjera parandaluese, diskutoni me ekspertin e SSHP-së.			

11.	A janë zgjedhur PPM-të në bazë të vlerësimit të riskut të vendit të punës? Rregullore (MPMS) Nr.02/2016, Neni 5.1, 5.2, 7.1. * <i>Kontrolloni ndërlidhjen mes dokumenteve të vlerësimit të riskut (rreziqet e identifikuara), PPM-ve (referenca për standardet që shpjegojnë nivelin e mbrojtjes) dhe vëzhgimeve gjatë vizitës në terren.</i>			
12.	A janë të disponueshëm katalogët e përditësuar të pajisjeve personale mbrojtëse për secilin profesion? Rregullore (MPMS) Nr.02/2016, Neni 5.2, 7.1.2, 7.2 * <i>Kontrolloni katalogun për të parë nëse të gjitha vendet e punës që keni mbikëqyrur gjatë vizitës në lokacion janë përfshirë në katalog - krahasoni shënimet/fotot që keni bërë gjatë vizitës inspektuese dhe informacionin në katalog për të kontrolluar nëse:</i> ○ <i>të gjitha PPM-të e nevojshme janë përmendur në katalog;</i> ○ <i>të gjitha PPM-të e përmendura në katalog përdoren nga punëtorët në vendet e punës.</i>			
13.	A janë të disponueshme rregullat e përditësuara të përgjithshme të përdorimit të PPM-ve? Rregullore (MPMS) Nr.02/2016, nenet 5.2, 7.1.2, 7.2. 8.1 * <i>Kontrolloni rregullat për të parë nëse të gjitha vendet e punës që keni mbikëqyrur gjatë vizitës në lokacion janë përfshirë në to - krahasoni shënimet/fotot që keni bërë gjatë vizitës në vendet e punës dhe informacionin në katalog;</i> * <i>Kontrolloni nëse keni dëshmi që punëtorët janë informuar për rregullat.</i>			

14.	A i keni përfshirë të punësuarit apo përfaqësuesit e tyre në përzgjedhjen, ofrimin, përdorimin dhe mirëmbajtjen e PPM-ve? Rregullore (MPMS) Nr.02/2016, Neni 8.4 <i>* A kishte ndonjë mundësi për të provuar madhësi të ndryshme, modele të dorëzave, çizmeve, si është përzgjedhur modeli i rrobave?.</i> <i>* A diskutuat me të punësuarit për modelin e rrobave të punës (p.sh. numrin dhe vendin e xhepave)?</i>			
15.	A janë të disponueshme dokumentet e PPM-ve nga prodhuesi? Rregullore (MPMS) Nr.02/2016, Neni 6.1, 6.2. <i>* Kontrolloni disponueshmërinë e certifikatave të pajtueshmërisë për PPM-të e inspektuara gjatë vizitës në terren (lidheni këtë pyetje me PPM-të e inspektuara në pikën 9 të kësaj liste kontrolluese).</i> <i>* Kontrolloni disponueshmërinë e udhëzimeve të prodhuesit për PPM-të e inspektuara gjatë vizitës në terren (lidheni këtë pyetje me PPM-të e inspektuara në pikën 9 të kësaj liste kontrolluese).</i>			
	PAS VETËVLERËSIMIT			
	<i>* Diskutoni me menaxhmentin e lartë për vëzhgimet dhe konkluzionet tuaja për nevojën për përmirësime.</i> <i>* Diskutoni me menaxherin e nivelit të mesëm të lokacionit/vendit të punës së vizituar për vëzhgimet dhe konkluzionet tuaja për nevojën për përmirësime.</i> <i>* Në rast se keni një ofrues të shërbimit të jashtëm të SSHP-së ose ekspert të SSHP-së, diskutoni me të për vëzhgimet dhe konkluzionet tuaja për nevojën për përmirësime.</i> <i>* Zbatoni masat e nevojshme të kontrollit të identifikuar gjatë vetë-vlerësimit.</i>			